



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.63/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Nenad Lazić dhe Adnan Konushevci anëtarë, si dhe me pjesmarrjen e zyrtarit të lart ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkitazi me ankesën e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), paraqitur kundër Koalicionit PDK-AAK-NISMA dhe Koalicionit LDK-AKR , për shkak të vendosjes së posterave në rrugë dhe në hapsira publike për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 06.06.2017, mori këtë:

V E N D I M

I. Pranohet si e bazuar ankesa e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), kështu që Koalicionit PDK-AAK-NISMA, i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 1,700.00 (njëmijë e shtatëqind) euro, dhe Koalicionit LDK-AKR i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 1,700.00 (njëmijë e shtatëqind) euro.

II. Koalicioni PDK-AAK-NISMA dhe Koalicioni LDK-AKR-NISMA, **detyrohen** ti paguajnë gjobat e shqiptuar si në pikën -I-, të dispozitivit të këtij vendimi, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të këtij vendimi, **nën kërcënim të përmbarimit.**

A r s y e t i m

Me datën 05.06.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga Institutit Demokratik të Kosovës (KDI) me të cilën pretendon se me datën 04.06.2017 në rrugën kryesore të qytetit Mbreteresha Teutë në Pejë monitoruesit e tyre kanë hasur në postere të kandidatëve për deputet nga koalicioni PDK-AAK-NISMA si dhe të Koalicionit LDK-AKR të ngjitura në hapsira publike dhe në tranfon e semaforëve të qytetit. Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se është bërë shkelje e dispozitës së Nenit 33 paragrafi 1 pika b) i LZP-së. Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur fotografi të printuara dhe CD lidhur me rastin në fjalë.

Në përgjigje në ankesë të datës 06.06.2017, koalicioni PDK-AAK-NISMA thekson se shkeljet nuk janë të qëllimshme dhe se kjo është bërë nga aktivist të pa informuar mirë me rregullat zgjedhore, prandal lidhur me këtë koalicioni PDK-AAK-NISMA ka evituar shkeljet dhe ka ndermar te gjitha veprimet duke i larguar te gjitha ato nga vendi ku kanë qene te vendosura

Si dëshmi ka bashkangjitur fotografit me të cilat shihet se janë larguar posterat nga vendi ku kanë qenë të vendosura ato.

Në përgjigje në ankesë të datës 06.06.2017, koalicioni LDK-AKR, thekson se pas pranimit të ankesës në përputhje me nenin 120 par 1 pika a) të LZP-së, kanë urdhëruar kandidatin e tyre që të ndërmar veprime përmisuese lidhur me evitimin e shkeljeve të theksuara në ankesë. Si dëshmi ka bashkangjitur fotografit ku shihen posterat e larguar nga vendi ku kanë qenë të vendosura ato.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

Ankesa është e bazuar

Nga fotografitë e ofruara si provë e cila gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë se posterat e kandidatëve për deputet nga radhët e Koalicionit PDK-AAK-NISMA dhe të Koalicionit LDK-AKR janë vendosur në rrugë dhe në objekte publike, veprime këto që janë në kundërshtim me nenin 33 pika b) të LZP-së e cila përcakton: *“Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në objekte dhe në rrugë publike.*

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret ngase subjektet politike të koalicionit PDK-AAK-NISMA dhe të Koalicionit LDK-AKR, kanë marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara dhe se janë të njoftuar me rregullat zgjedhore, si dhe faktin se posterat e kandidatëve për deputet nga këto koalicione janë të vendosura në rrugë dhe në objekte publike.

Paneli e urdhëroi koalicionin PDK-AAK-NISMA dhe Koalicionit LDK-AKR, për ta përmirësuar shkeljen e kodit të mirësjelljes për subjektet politike, ku të njëjtit brenda afatit të caktuar, kanë ndërmarr veprimet e duhura për evitimin e shkeljeve duke i larguar menjëherë posterat nga vendi ku ka ndodhur shkelja, të cilat veprime kanë ndikuar në lartësin e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi.

Duke u nisur nga arsyet e theksuara me lartë, Paneli konstaton se nga ana e koalicionit PDK-AAK-NISMA dhe Koalicionit LDK-AKR, është shkelur neni 33 pika (b) të LZP-së, pasi që posterat e kandidatëve për deputet nga koalicioni PDK-AAK-NISMA dhe Koalicionit LDK-AKR, janë vendosur në objekte dhe në rrugë publike dhe duke pasur parasysh veprimet e menjëhershme të koalicioneve në fjalë që kanë ndërruar për evitimin e shkeljeve si dhe përpjekjet për të parandaluar veprimet e ndaluara në bazë të provave të cilat i kanë ofruar të bashkangjitura përgjigjeve në ankesë e të cilat veprime kanë ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar.

Paneli në kuptim të nenit 120.1 pika c) dhe nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës

Anr.63/2017 më datën 06.06.2017.



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.